

# MONITORI I TË DREJTAVE PRONËSORE

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) punon me institucionet përkatëse të Kosovës për të përkrahur zbatimin e kornizës së politikave dhe asaj ligjore për mbrojtjen e të drejtave pronësore e banesore të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe personave të zhvendosur (PZH). Për të ndihmuar në këto përpjekje, OSBE-ja rregullisht monitoron dhe raporton mbi zhvillimet, si dhe këshillon institucionet në respektimin e legjislacionit përkatës, standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira. Monitori i të Drejtave Pronësore është publikim gjashtëmujor i vrojtimit të monitoruesve të OSBE-së në pesë rajonet vijuese, Prishtinë (PR); Mitrovicë (MI); Gjilan (GN); Pejë (PE); dhe Prizren (PZ). Ky publikim mëton të ofrojë një pasqyrë të gjendjes në terren, e cila nuk është në dispozicion, mbi të drejtat pronësore dhe banesore të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve, që do të duhej t'i ndihmonte institucioneve përgjegjëse në adresimin e çështjeve shqetësuese, moszbatimit të legjislacionit si dhe/ose moszbatimit të vendimeve, si mekanizëm për përcjelljen e progresit të arritur dhe plotësimin e mangësive të identifikuara. Informatat e prezantuara më poshtë janë paraqitur ashtu si janë mbledhur nga ekipet e OSBE-së në terren, si dhe nuk përfshin raste të tjera të cilat mund të jenë raportuar te institucionet përgjegjëse të Kosovës ose agjencitë e specializuara, në të cilat OSBE-ja nuk ka qasje. Të dhënat e ofruara në këtë edicion mbulojnë periudhën nga fillimi i janarit deri në fund të qershorit 2019.

## EDICIONI 1: JANAR - QERSHOR 2019

### TEMAT

**Shpronësimi** përbën ndërhyrje të autoriteteve në prona private dhe publike, me qëllim të arritjes së një interesi të caktuar publik. Ky proces i nënshtrohet kushteve të përcaktuara me ligj, ku parashihet edhe kompensimi për pronarët e prekur. Ky edicion i Monitorit paraqet numrin e ndërhyrjeve që prekin pronat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve.

**Uzurpimi i paligjshëm** i pronës është vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal. Pronat e komuniteteve joshumicë vazhdimisht u janë nënshtruar uzurpimeve të paligjshme. Ky edicion i Monitorit pasqyron numrin e uzurpimeve të paligjshme të pronës që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese.

**Banimi social** është detyrim i autoriteteve për të adresuar nevojat e banimit të individëve dhe familjeve që nuk mund t'i përballojnë vetë kushtet e duhura të jetesës. Ky edicion i Monitorit paraqet numrin e rasteve nga grupet e cenushme, siç janë gratë dhe komunitetet joshumicë, të cilët kanë përfitur nga ofrimi i banesave sociale.

**Trajtimi i ndërtimeve pa leje** është proces që zbatohet nga autoritetet për të legalizuar ndërtimet pa leje. Ky edicion përfshin numrin e rasteve të ndërtimeve pa leje në pronat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, e që i nënshtrohen legalizimit.

**Planifikimi hapësinor** është strategjia e autoriteteve për rregullimin e territorit në të gjitha nivelet. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor është thelbësore, jo vetëm për vlerësimin dhe shprehjen e nevojave të komuniteteve, por edhe për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave pronësore të individëve. Ky edicion pasqyron numrin e proceseve të planifikimit hapësinor, në të cilat është shënuar pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë.

**Ndarja e tokës komunale** për projektet që kanë të bëjnë me kthimin është procedurë/iniciativë e autoriteteve e ushtruar me qëllim të përmbushjes së një interesi dhe/ose politike publike. Ky edicion paraqet numrin e komunave që kanë ndarë toka komunale për projekte të kthimit dhe/ose për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë gjatë periudhës së raportimit.

**Tatimi mbi pronën e paluajtshme** është pagesë e detyrueshme e përcaktuar dhe zbatuar nga autoritetet për pronësinë e pronave banesore, bujqësore dhe komerciale. Megjithatë, ka raste ku pronat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë kanë qenë/janë të uzurpuara dhe, si pasojë, pronari vazhdon ta bartë barrën e detyrimit tatimor përkundër faktit që nuk gëzon posedim fizik të asaj prone. Ky edicion paraqet numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë të liruar nga pagesa e tatimit mbi pronën e paluajtshme për pronat e uzurpuara paligjshëm.

### RASTET E SË DREJTËS PRONËSORE QË PREKIN KOMUNITETET JOSHUMICË NË TË GJITHË KOSOVËN

SHPRONËSIMI

346

UZURPIMI I PALIGJSHËM

6

BANIMI SOCIAL

33

TRAJTIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE

0

PLANIFIKIMI HAPËSINOR

5


NDARJA E TOKËS

0

TATIMI MBI PRONËN E PALUAJTSHME

0

## Rastet e shpronësimit sipas rajonit




## Shpronësimi

Gjatë periudhës së raportimit, kemi regjistruar **346 raste** në të cilat procesi i shpronësimit ka prekur pronat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe/ose PZH-ve. Në rajonin e Pejës, ndërtimi i pjesës lokale të magjstrales Klinë-Pejë ka prekur **318** prona që i përkasin komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve, ndërsa në rajonin e Gjilanit, ndërtimi i autostradës Prishtinë - Shkup ka prekur **28** prona. Në rajonet e Prishtinës, Mitrovicës dhe Prizrenit, nuk ka pasur raste të shpronësimit.

## Uzurpimi i paligjshëm

Ka pasur gjithsej **6 raste të uzurpimit të paligjshëm** që prekin pronat që i përkasin pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve. Të gjitha uzurpimet e paligjshme kanë ndodhur në rajonin e Pejës. Gjatë periudhës raportuese, autoritetet kanë ngritur akuza penale në dy raste, ndërsa një uzurpues i paligjshëm ka liruar një pronë.


## Rastet e uzurpimit të paligjshëm për rajon




## Banimit social

Gjatë periudhës së raportimit, në rajonin e Prishtinës, në komunën e Graçanicës, **33 prona** (banesa) janë ndarë për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe gratë, për qëllime të banimit social. Të gjithë përfituesit i përkasin komunitetit serb të Kosovës.

## Pronat e ndara për qëllime të banimit social, sipas rajonit



## Rastet e legalizimeve sipas rajonit




### Legalizimi

Për shkak të reformave të vazhdueshme legjislative, **procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje nuk ka filluar ende.**

Ligji i ri nr. 06/L-024 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje ka hyrë në fuqi më 5 shtator 2018. Megjithatë, zbatimi i tij nuk ka mundur të fillojë deri në hyrjen në fuqi të Udhëzimeve Administrative (UA). Këto UA u nënshkruan nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe hynë në fuqi më 15 korrik 2019. Edicioni i dytë i Monitorit të të Drejtave Pronësore do të elaborojë më shumë rreth kësaj teme.

## Pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë në proceset e planifikimit hapësinor në rajone



### Planifikimi hapësinor

Gjatë periudhës së raportimit, pjesëtarët e komuniteteve joshumicë morën pjesë në **5 procese të planifikimit hapësinor** – tre në Prizren, një në Prishtinë dhe një në rajonin e Gjilanit.


## Ndarja e tokës për komunitetet jo-shumicë për rajon

	PR	MI	GN	PE	PZ
■ Numri i rasteve	0	0	0	0	0

### Ndarja e tokës

Nuk është raportuar asnjë rast i ndarjes së tokës komunale për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë apo PZH-të, lidhur me projektet e kthimit të tyre.

### Tatimi mbi pronën e paluajtshme



### Tatimi mbi pronën e paluajtshme

Përkundër faktit se Ligji i ri nr. 06/L-005 për Tatimin mbi pronën e paluajtshme ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2018, **asnjë nga komunat nuk ka filluar zbatimin e nenit 39** të këtij ligji, që liron nga detyrimi tatimor ata persona, pronat e të cilëve janë uzurpuar më parë apo janë të uzurpuara aktualisht, në bazë të vendimit përfundimtar të nxjerrë nga autoriteti kompetent publik në shqyrtimin e rasteve të uzurpimit të paligjshëm.